




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. \_\_\_\_\_  
 Dep. 2-D/DPK  
 Nr. I faq. \_\_\_\_\_  
 Broj stranica \_\_\_\_\_  
 Nr. pages \_\_\_\_\_

Nr Prot. \_\_\_\_\_  
 Br. Prot. 01-3179/14  
 Prot No. \_\_\_\_\_  
 Data \_\_\_\_\_  
 Datum 10.09.2014  
 Date \_\_\_\_\_

PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	10/09/2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Labinot MAZREKU Menaxher i Prokurimit – Komuna Malishevë
CC:	z. Ragip BEGAJ Kryetar - Komuna Malishevë
NGA/OD/FROM:	<i>për</i> z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Ndërtimi i Objektivit të Shkollës Filllore në Fshatin Bubavec”



I nderuar z. MAZREKU

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: “Ndërtimi i Objektivit të Shkollës Filllore në Fshatin Bubavec” me nr. prokurimi: 62500-14-075-521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

**OPINION**

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin “Ndërtimi i Objektivit të Shkollës Filllore në Fshatin Bubavec” me nr. prokurimi: 62500-14-075-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Komuna e Malishevës, si Autoritet Kontraktues ka përgatitur “Njoftimin për Kontratë” me titull: “Ndërtimi i Objektivit të Shkollës Fillore në Fshatin Bubavec” me nr. prokurimi: 62500-14-075-521. Ky aktivitet prokurimi më datë 01/09/2014 është publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Agjencia Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim. Gjatë trajtimit të kësaj procedure të prokurimit nga “Dosja e Tenderit”, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në “Njoftim për Kontratë”, pika III.2.3 – Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar: Raportin e Auditimit të vitit 2012, 2013; QARKULLIMI FINANCIAR 1.000.000.00€ në tri vitet e fundit (2011,2012,2013) si dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare: Lista e mjeteve të punës të OE. Raporti i Auditimit është kërkuar për dy vitet e fundit (2012, 2013), ndërsa qarkullimi financiar në tre vitet e fundit (2011, 2012, 2013). Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur për qëllim që të vërtetohet për qarkullimin financiar përmes Raportit të Auditimit, është dashur ti përputh vitet me kërkesën tjetër për qarkullimin financiar. Konsiderojmë gjithashtu se qarkullimi i kërkuar financiar në vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, kalon dyfishin e vlerës së parashikuar të projektit. Nga këto dy kërkesa në lidhje me Kapacitetin Ekonomik dhe Financiar, dëshmia e kërkuar dokumentare është paraqitur: Lista e mjeteve të punës të OE. Sipas ligjit të Prokurimit Publik, qarkullimi financiar nuk mund të dëshmohet me listën e mjeteve të punës.

Në “Njoftim për Kontratë” pika IV.3.5 - A është e nevojshme siguria e tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sigurinë e tenderit në vlerë prej 5.000 €. Duke llogaritur vlerën e parashikuar të projektit, vlera e cila është caktuar nga Autoriteti Kontraktues, nuk është në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Në “Njoftim për Kontratë” pika III.2–Kushtet për Pjesëmarrje, III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë, nënpika: 10.STAFI I PUNËTORËVE, kërkohet: Numri i punëtorëve së paku TRIDHJETË (30) punëtor si dëshmi kontributin e tyre në ATK për tre muajt fundit (Maj, Qershor, Korrik viti 2014) dëshmia e pagesave e vërtetuar nga ATK-ja (origjinali). Autoriteti Kontraktues, për të vërtetuar kapacitetin teknik dhe profesional, mundet të kërkoj nga Operatori Ekonomik të dëshmoj minimumin e mesatares së fuqisë punëtore dhe stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet, e jo siç është kërkuar numri i caktuar i punëtorëve për tre muajt e fundit të këtij viti.

Autoriteti Kontraktues po ashtu në Dosjen e Tenderit pika 8.1 tek Kërkesat mbi gjendjen Ekonomike dhe Financiare nuk ka plotësuar asgjë, është rubrikë e zbrazët, ndërsa kapacitetin ekonomik dhe financiar, gjegjësisht qarkullimin financiar e ka kërkuar në rubrikën 7.1 tek Kërkesa e Përshtatshmërisë Profesionale.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi; nenin 27 Dosja e Tenderit; Neni 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; pika 26 Sigurimi i Tenderit dhe pika 23.Kriteret e përzgjedhjes nga Udhëzuesi Operativ i prokurimit Publik si dhe Neni 5 Gjendja Ekonomike dhe Financiare i Udhëzimit Administrativ 02/2014

Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon që të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për operatorët ose operatorët ekonomik potencial.

Agjencia Kundër Korrupsion konsideron se praktika të tilla nuk duhet lejuar, andaj rekomandon anulimin e këtij aktiviteti, duke mos i përsëritur praktikat e ngjashme në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!

